



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**PSH. nr. 61/17**

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK** i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, në përbërje **Tefik Sylejmani –Kryetar, Ekrem Salihu-Referues dhe Goran Milenkovič- Anëtar**, duke vendosur sipas ankesës me nr. të protokollit 61/17, të parashtruar nga operatori ekonomik **“BOTEK” sh.p.k.** me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqësoj Hilmi Asllani, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me teknologji informative për nevojat e MASHT-it”** me nr. të prokurimit 208/17/001/111, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në seancën e dt. 06 prill 2017, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **Aprovohet**, ankesa e operatorit ekonomik **“BOTEK” sh.p.k.** me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me teknologji informative për nevojat e MASHT-it”** me nr. të prokurimit 208/17/001/111, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si e bazuar.
- I. **Anulohet**, vendimi i Autoritetit Kontraktues Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë njoftim për kontratë, për aktivitetin e prokurimit me titull: **“Furnizim me teknologji informative për nevojat e MASHT-it”** me nr. të prokurimit 208/17/001/111, dhe lënda kthehet ne Ri tenderim.
- II. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim.
- III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

IV. Operatorit ekonomik ankues **“BOTEK” sh.p.k.** me seli në Prishtinë konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

V. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### ARSYETIM

Autoriteti kontraktues—Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, më dt. 02 shkurt 2017, ka publikuar *Njoftim për kontratë* lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me teknologji informative për nevojat e MASHT-it”** me nr. të prokurimit 208/17/001/111.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Kundër refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, të dt. 21 shkurt 2017, operatori ekonomik **“BOTEK” sh.p.k.** nga Prishtina, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-së.

#### **Pikat e ankesës:**

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 28 të LPP-së, sepse specifikimet teknike në dosjen e tenderit janë kopjuar 100%, nga broshurat e prodhuesve të caktuar si Lenovo, Lexmark, Digitus, APC, Konica, ku mund të shihet qartë që specifikimet janë 100% për prodhues të caktuar dhe nuk mund të plotësohen nga prodhues tjerë.

Ankesa e operatorit ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 08 mars 2017, ka autorizuar ekspertin shqyrtues dhe ekspertin teknik, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/teknik me datën 20 mars 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raportin e tij ka konstatuar: në bazë të fakteve të ankesës së bërë nga OE ankues **“BOTEK” sh.p.k.**, i cili pretendon që janë bërë shkelje të nenit 28. Specifikimet teknike pika 2 dhe pika 7,



nga ana autoritetit kontraktues MASHT, nuk qëndrojnë pretendimet e OE "Botek" shpk për shkelje e bëra nga AK MASHT në bazë të Nenit 28. Specifikimet teknike pika 2 dhe pika 7.

Për arsye se çdo autoritetit kontraktues ka të drejtë të përcaktojë specifikimet teknike në bazë të kërkesave dhe nevoja që ka. Autoriteti kontraktues në këtë rast MASHT, i ka bërë specifikimet teknike në bazë të nevojave që ka e jo për favorizim të ndonjë operatori ekonomik të caktuar.

Eksperti shqyrtues/teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues ta refuzoj si të pa bazuar, ndërsa të aprovoj vendimin e autoritetit kontraktues njoftim për kontratë, të dt. 02 shkurt 2017.

Autoriteti kontraktues Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, përmes parashtresës me shkrim të dt. 23 mars 2017, e njofton panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 20 mars 2017.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të dt. 23 mars 2017, njofton panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertizës të dt. 20 mars 2017.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimit për kontratë, dosja e tenderit, raporti i ekspertit shqyrtues/teknik i dt. 20 mars 2017, parashtresa e operatorit ekonomik ankues, parashtresa e autoritetit kontraktues mbi raportin e ekspertit shqyrtues, si dhe deklarata e palëve gjatë seancës dëgjimore.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues z. Asllani, gjatë seancës dëgjimore deklaroj: në dosje të tenderit **"Furnizim me teknologji informative për nevojat e MASHT-it"** me nr .prok. 208/17/001/111, janë kërkuar 40 produkte të teknologjisë informative, ku për 13 pozicione është kërkuar edhe autorizim i prodhuesit dhe deklaratë e prodhuesit për Garancinë. Me një kërkim të thjeshtë në internet (google) mund të konstatohet qartë se specifikat në këtë dosje janë përpiluar 100% duke kopjuar (copy/paste) nga broshurat e caktuara dhe përshtatur prodhuesve të caktuar si Lenovo, Lexmark, Epson etj. Kjo përbën favorizim direkt të një distributori dhe prodhuesve të caktuar duke diskriminuar dhe përjashtuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik me produkte ekuivalente të prodhuesve të tjerë.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues ne vazhdim të prezantimit theksoi: këto specifika nuk mund të plotësohen nga asnjë prodhues tjetër si: Dell, HP, apo edhe prodhues tjerë, dhe qartësisht është në kundërshtim me LPP-në përkatësisht neni 28 specifikimet teknike pika 2 citoj: "AK-së është veçanërisht i ndaluar të hartoj specifikimet teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një apo më shumë operator ekonomik".

Në vazhdim të seancës përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues ua prezantoi/deponoi panelit shqyrtues deklaratën së bashku me provat në një formë tabelave, një listë të krahasimit, 1 deri në 5, ku në anën e majtë është përshkrimi i specifikimeve teknike në dosje të tenderit, ndërsa anën tjetër janë specifikat copy/paste nga broshurat e prodhuesve të caktuar siç ceku më lart, Lenovo, Lexmark, Epson etj. Nëse krahasojmë specifikat e dosjes dhe ato nga broshurat shihet se janë 100% të njëjta, ku për secilin produkt janë të kopjuara specifikat.



Me anë të këtyre provave përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues theksoi: shihet qartë se autoriteti kontraktues gjatë përpilimit të specifikimeve teknike i referohet një artikulli / burimi të veçantë dhe prodhuesve të caktuar në kundërshtim me LPP-në neni 28 pika 7 citoj “AK-të nuk do përpilojnë specifikime teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm ose shenje dalluese, lloj, ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhim”. Për informacion t panelit lista e plotë prej 13 produkte ka qenë së bashku me ankesën tonë pranë OSHP, si dhe me kërkesën për rishqyrtim të 21.02.2017.

Për të rikonfirmuar këtë pretendim tonin të bazuar kemi kontaktuar me distributor të tjerë këtyre prodhuesve Lenovo, Lexmark, Lexus, dhe kemi marr njoftimin me shkrim “projekti është shkruar dhe bllokuar nga një distributor i caktuar lokal në Kosovë dhe nuk mund të na dërgoj çmime dhe dokumente të kërkuara si MAF”. Këtë ja ofroj panelit si prova numër 1.

Përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues ne vazhdim të prezantimit theksoi: pra bazuar në këto prova të pamohueshme mund të konstatohet se autoriteti kontraktues ka favorizuar OE dhe distributor dhe prodhues të caktuar, dhe ka bërë shkelje të qartë edhe të nenit 7 barazia në trajtim dhe jo diskriminim.

Për më tepër në ekspertizën e lëndës, gjitha këto shkelje të evidentuara me prova të pamohueshme dhe të dokumentuara nuk janë trajtuar fare, duke nxjerr përfundim të përgjithshëm të pabazuar në asnjë argument të vetëm teknik dhe administrativ dhe për mendimin tonë kjo ekspertizë është tendencioze dhe e papranueshme.

Po ashtu ekspertëve çuditërisht nuk i ka bërë përshtypje fare fakti numër 2, i dorëzuar nga ne ku konfirmohet se dokumenti i specifikave teknike në këtë dosje është shkruar nga një punëtor me emër dhe mbiemër të një distributori lokal në Kosovë (kompania ITD), dhe këtë mund ta vërtetoni përmes internetit në faqe të KRPP-së, ku figuron emri i personit që ka përpiluar dokumentin.

Edhe ky fakt rikonfirmon qartazi pretendimet tona të bazuara se përshkrimi teknik i specifikacioneve ka qenë i planifikuar dhe përshkruar nga një distributor i caktuar në Kosovë në bashkëpunim me zyrtarët e MASHT-it, me qëllim të qartë të favorizimit të një distributori dhe prodhuesve të caktuar duke bërë përshkrim të specifikave 100% të njëanshëm dhe kundërshtim me LPP-në neni 28 dhe nenin 7 të këtij Ligji.

Në fund të prezantimit përfaqësuesi i operatorit ekonomik ankues shtoi, duke pas për bazë gjitha këto shkelje të bazuara në fakte dhe prova të pamohueshme lus panelin që këtë lëndë ta anuloj duke kërkuar që autoriteti kontraktues të respektoj LPP-në dhe nenet në fjalë, gjatë përpilimit të specifikave teknike dhe të ndërmarr masa sipas ligjit për gjitha këto shkelje të lartpërmendura.

Përfaqësuesi i AK-MASHT z. Alimusaj, gjatë seancës dëgjimore deklaroi: autoriteti kontraktues dhe njësia kërkesë ka bërë specifikat teknike, dhe kemi marr konfirmim se asnjë pajisje nuk është diskriminuese dhe nuk i është përshtat asnjë distributori. Kërkesa jonë është që të kemi pajisje cilësore dhe të garantuara. Ne kundërshtojmë plotësisht ankesën e dhe pretendimet e OE ankues “Botek”, dhe mendojmë se pretendimet janë të pabazuara.



Përfaqësuesi i autoritetit kontraktues në fund të prezantimit theksoi: qëndrojmë pranë vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dhe pajtohemi me ekspertizën e ekspertëve të cilët kanë rekomanduar që të refuzohet ankesa e operatorit ekonomik ankues dhe të aprovohet vendimi i AK-së.

Ekspertja shqyrtues znj. Bullatovci, deklaroj: me qenë se pretendimet ankimore kanë qenë të gjitha për specifika teknike, kam kërkuar të angazhohet ekspert teknik për trajtimin e pretendimeve ankimore andaj fjalën do ja kaloja ekspertit teknik.

Ekspertit teknik z. Hoxha, deklaroj: qëndroj pran asaj që kam potencuar në raportin e ekspertizës.

Specifikat teknike vetëm në raste kur përcaktohet emri paraqet shkelje, përndryshe specifikat teknike përcakton vet autoriteti kontraktues për nevojat e veta. Specifikat teknike të autoritetit kontraktues nuk paraqesin shkelje të LPP-së.

Anëtari i panelit z. Salihu pyeti ekspertin teknik se operatori ekonomik ankues pretendon se specifikacioni i është përshtatur 100% prodhuesve të caktuar për 13 pozicione, a keni bërë përpjekje për të vërtetuar pretendimet ankimore duke hyrë në faqe të prodhuesve dhe duke krahasuar me specifikacione teknike për secilin produkt.

Në përgjigje z. Hoxha deklaroj: kam bërë hulumtimin dhe me gjithë se specifikat teknike të dosjes përshtaten me prodhues të caktuar kjo nuk përbën shkelje sipas mendimit tim.

Pretendimi i operatorit ekonomik ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 dhe 28 të LPP-së, paneli shqyrtues konstatoj se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se autoriteti kontraktues ka hartuar specifikimet teknike duke ju përshtatur prodhuesve të caktuar, ndërsa në bazë të nenit 28 paragrafi 2 i LPP-së, autoriteti kontraktues është obliguar t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, konstatimeve të cekura në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues/teknik, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, deklaratës së përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankues, deklaratës së përfaqësuesit të autoritetit kontraktues, deklaratës së eksperti teknik dhënë gjatë seancës dëgjimore, konstatoj se autoriteti kontraktues me rastin e hartimi të specifikimeve teknike në aktivitetin e prokurimit **“Furnizim me teknologji informative për nevojat e MASHT-it”** me nr .prok. 208/17/001/111, nuk ka respektuar nenin 7 dhe nenin 28 të LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

**KSHILLA JURIDIKE :**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,  
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet  
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative  
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

  
Ferik Sylejmani

